



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLICA OF KOSOVO
 Qeveria - Vlada / Vlada Kosova / Government
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archiving

Kopje origjinali / Original copy / Original
 C/S: 024471 / 4274 / 2022
 Dato / Date / Datum: 29.03.2022
 Prishtine / PRISTINE / A

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ardian Gjini , Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbënesh Kuqi , Kryesuese e Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Venera Çerkini , Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Hekuran Murati , Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Elit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 019/2022
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Elmedina Bajgora , Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Shqyrtimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Gjini,
 E nderuara Kryesuese znj. Kuqi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe

Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim për mbështetje financiare të Shoqatës 'Handikos' në Gjakovë</i>
<i>I miratuar më datë 07.03.2022</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 08.03.2022</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 09.03.2022</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Gjakovës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Gjakovës, me anë të aktit administrativ komunal, ka synuar ndarjen e mjeteve financiare të kësaj organizate buxhetore për mbështetjen financiare të Shoqatës 'Handikos' në Gjakovë përmes kategorisë së "subvencioneve dhe transfereve".
2. Si pikë e parë, edhe përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitet obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP"), gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7
Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitet duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parasë publike, neni 17 i LMFPP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].
4. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Gjakovës, ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për këtë vit fiskal.
5. Përkundër kësaj, si dhe duke konsideruar që shqyrtimi i aktit komunal nuk reduktohet vetëm në shumën e ndarë për financim, Ministria e ka verifikuar statusin e Shoqatës "Handikos Gjakova" në Sistemin Elektronik të Organizatave Jo-Qeveritare (SEOJQ). Sipas të dhënave në këtë sistem, Shoqata është e regjistruar si Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ).
6. Për financimin publik të OJQ-ve, në gamën legjislative të Ministrisë evidentohen si relevante dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (këtej e tutje referuar si "Rregullore për

Financimin e OJQ-ve'). Rrjedhimisht, dispozitat e kësaj Rregullore janë të zbatueshme dhe relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal në këtë vit fiskal.

7. Në rastin konkret, Ministria nuk ka pranuar dëshmi, si por duke mos u kufizuar në dëshminë e thirrjes publike dhe themelimin e Komisioneve relevante, për të konstatuar nëse subvencionimi është realizuar konform dispozitave të Rregullores.
8. Si përfundim, Ministria sqaron se vetëm nëse përgjatë marrjes së këtij vendimi janë zbatuar dispozitat e Rregullores për Financimin e OJQ-ve, mund të konstatohet se Komuna mund ta realizojë masën e përcaktuar me aktin komunal. Në të kundërtën, akti komunal mbetet i kundërligjshëm dhe/ose i pazbatueshëm, nëse nuk ka pasur zbatim të procedurave të përcaktuara me Rregulloren për Financimin e OJQ-ve nga ana e Komunës së Gjakovës.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Gjakovës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

[Kthehu në kërkim](#)

Të dhënat e organizatës

Emri i organizatës

Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Gjakovës

Shkurtesa e organizatës

HANDIKOS GJAKOVË

Numri i regjistrimit

5116253-8

Lloji i OJQ-së

Shoqatë

Adresa e OJQ-së

Gjakovë, Gjakovë, Gjakovë, Rr:Anton Qetta, pr,

Numri i telefonit

- (Tel)

044/424-266 (Mob)

0390/327-150 (Fax)

Email

brilanda.ballata@hand-kos.org

Data e regjistrimit

01/07/2016

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri e mbiemri

Brilanda Ballata

Funksioni zyrtar

Drejtor

Themeluesit

Islam Kasumaj

Sanija Tolja

Hysen Avdullahu

Rilind Hoxha

Ahmet Binaku

Gjendja e Statusit të Përfitimit Publik

Statusi

Numri SPP

Data e regjistrimit të SPP

///

///

Misioni, qëllimi dhe aktivitetet e organizatës

Misioni

Qëllimi i OJQ-së

Mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara
 Përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara
 Ofrit të shërbimeve për personat me aftësi të
 kufizuara Pjesëmarrjes së personave me aftësi të
 kufizuara në jetën publike

Fushëveprimtaritë

Përshkrimi i aktiviteteve

Aftësi të kufizuara

© 2016, Ministria e Administratës Publike



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm në MFPT	
Kopje:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Date: 08.03.2022 020-233
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të për përcjelljen e Komunave aktit në Ministri të Urtisë 2. Zyrtari përgjegjës Vjosa Ahmetaj, Zyrtar për Monitorimin e Komunave për hartimin e shkresës përcjellëse	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar "Vendim për mbështetje financiare të shoqatës "Handikos Gjakovë", e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës, dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullore (qrk) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendim për mbështetje financiare të shoqatës "Handikos Gjakovë"

E miratuar më datë: 07.03.2022

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.03.2022



KOMUNA E GJAKOVËS

MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
 Nr. _____ 2022
 datë 07.06.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 12 i ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 037-010, nën titullin 18 pikë 1 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011-10 i miratuar 16.12.2003, dhe në nën titullin 13 të Rregullores 1 nr.110-01-3650 mbi Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës e miratuar me dt. 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.06.2022 pas diskutimit lidhur me pikën 1 të rendit të ditës "Propozim Vendi" për mbështetje financiare të Shoqatës "Handikos Gjakovë" e miratohet kështu:

V E N D I M

Për

mbështetje financiare të shoqatës "Handikos Gjakovë"

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës "Handikos Gjakovë" për mbështetje financiare në vlerë prej 20.000€ me qëllim të përkrahjes për konfirmimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që shërbime nga "Handikos Gjakovë".
2. Mënyra financiare në vlerë prej 20.000€ për Shoqatën "Handikos Gjakovë" ndahet nga kategoria e Subvencioneve Komunale të Drejtuarisë për Shëndetësi dhe Mirëqenitje Sociale.
3. Përbëhen organet e Administratës Komunale në kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi për diskutimin e tyreveve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të kësaj vendimi.
4. Ky vendim lëhet në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës.
5. Vendimi lëhet në fuqi:
 - Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Arifan Gjini
 - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtori i për Shëndetësi dhe Mirëqenitje Sociale
 - Drejtori i për Kulturë dhe Turizëm
 - Shërbimi profesional i Kuvendit të Komunës
 - Arkivi

Zyrtarisht miratohet

Kryetari i Komunës së Gjakovës



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2022

Datë: 07.03.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 18 pika C të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011-10 i miratuar 16.12.2008 , dhe në nenin 15 të Rregullores 01nr110/01-3650 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës e miratuar me dt. 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.03.2022 pas diskutimit lidhur me pikën 3 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për mbështetje financiare të Shoqatës "Handikos Gjakovë" e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

mbështetje financiare të shoqatës "Handikos Gjakovë"

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës "Handikos Gjakovë" për mbështetje financiare në vlerë prej 20.000€ me qëllim të përkrahjes për realizimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që ofrohen nga "Handikos Gjakovë" .
2. Mjetet financiare në vlerë prej 20.000€ për Shoqatën "Handikos Gjakovë" ndahen nga Kategoria e Subvencioneve Komunale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale .
3. Obligohen organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ,
 - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .



Znj. Arbëneshë Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	14.02.2022 01-011/01-3755
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lenda:	Propozim vendim për mbështetje financiare të shoqatës "Handikos Gjakova"

Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41 shkronja h të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datën 26.12.2008, dhe në bazë të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, me datën 14.02.2022 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miraton vendimin për mbështetje financiare të Shoqatës "Handikos Gjakova", me qëllim të përkrahjes së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar që ofrohen nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet "Hendikos Gjakova".
2. Mjetet për mbështetje financiare për Shoqatën "Handikos Gjakova", të ndahen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në vlerë prej 20,000€.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës së dytë të këtij Propozim -Vendimi.
4. Pjesë përbërëse Propozim –Vendimit është: Forma e buxhetit për mbulimin e shpenzimeve të prezantuar nga Shoqata "Handikos Gjakova".

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA ĐAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Skupština Opštine - Đakovica

01 Br.011/01-5477

Dt. 07.03.2022

Skupština Opštine Đakovica, na osnovu člana 12. Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03 / L-040, član 18 tačka C Statuta Opštine Đakovica 01nr.011-10 usvojen 16.12.2008, au članu 15 Pravilnika 01nr110 / 01-3650 o dodeli subvencija opštine Gjakova odobren na dt. 30.01.2020.godine, na sednici održanoj 07.03.2022.godine nakon rasprave po tački 3. dnevnog reda: Nacrt Odluke o finansijskoj podršci Udruženja „Handikos Đakovica“ usvojio je ovu:

O D L U K U

Për

Za

Finansijsku podršku udruženja „Handikos Đakovica“

1. Odobrava se zahtev Udruženja „Handikos Đakovica“ za finansijsku podršku u iznosu od 20.000 € u cilju podrške realizaciji usluga za osobe sa invaliditetom koje pruža „Handikos Đakovica“.
2. Finansijska sredstva u iznosu od 20.000 € za Udruženje „Handikos Đakovica“ izdvajaju se iz kategorije opštinskih subvencija Uprave za zdravstvo i socijalnu zaštitu.
3. Organi Opštinske uprave dužni su da sprovode sve postupke u skladu sa svim važećim zakonskim aktima za izvršenje finansijskih sredstava iz tačke 1. i 2. ove odluke.
4. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u protokol kancelarije Ministarstva za Lokalnu Upravu i sedam dana nakon objavljivanja na sajtu Opštine.

5. Odluka se Šalje:

- Predsedniku Opštine g. Ardian Gjini,
- Ministarstvu Administracije Lokalne Samouprave,
- Stručnoj Službi Skupštine Opštine,
- Direktorijatu za Buđet i Finasije,
- Direktorijatu za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu
- Arhivi,



Predsedavajuća Skupštine Opštine

gos. Arbeneša Kuči



Zyra – Gjakovë, Rr. Tiranë,
Tel.&Fax: +383 390 327 150 , +383 44 424 266
E-mail: handikos.gjakove@gmail.com

Për: Kryetarin e Komunës / Z. Ardian Gjini

CC: Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - DSHMS

Nga: Handikos Gjakovë, Kuvendi lokal i personave me aftësi të kufizuar edhe grupi avokus i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar në komunën e Gjakovës

Lënda: Kërkesë për mbështetje të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar për vitin 2022

Data: 27.01.2022 NR.P 34/22

I nderuar – Kryetar,

Ka dy vite prej kur keni filluar mbështetjen financiare të shërbimeve të Handikos Gjakovë ndaj personave me aftësi të kufizuara të Gjakovës. Bazuar në faktin se kjo kategori ka nevojë për shërbime të vazhdueshme pasi që në rast të ndërprerjes së këtyre shërbimeve rezulton me regres të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara.

Nisur nga ky fakt ne si Handikos Gjakovë ju kemi drejtuar me kërkesë për mbështetje financiare për ofrimin e shërbimeve ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara për vitin 2020 dhe 2021, gjë për të cilën u jemi shumë falenderues dhe mirënjohës që kërkesa ynë ka hasur në vullnetin tuaj të mirë dhe është aprovuar unanimisht nga këshilltarët komunal (Asambleistët).

Sikur vitin 2021, edhe këtë vit, Handikos Gjakovë po ju drejtohem me kërkesë Komunës së Gjakovës, për mbështetje financiare të shërbimeve të ofruara nga Handikos Gjakovë për vitin 2022. Kërkesa dhe projekt propozimi për mbështetje financiare i planifikuar për realizimin e programit të RBB-s për vitin 2022, është 32,740.00 € për 11 muaj.

I nderuar Kryetar, ne jemi të bindur se edhe këtë vit kërkesa jonë do të ketë aprovimin tuaj andaj ne në emër të gjithë personave me aftësi të kufizuara, përfutues të këtij programi ju jemi mirënjohës dhe shumë falenderues.

PS: Keni të bashkangjitur kërkesën me specifika të programit tonë për përkrahjen e shërbimeve për vitin 2022, që i ofroim për personat me aftësi të kufizuar.

1. Kërkesa
2. Projekt propozimi
3. Buxheti (me përshkrim të shpenzimeve)
4. Licensat
5. Raporti nerativ i vitit 2021

Me respekt!

Kryetarja i kuvendit të organizates

Sanija Toljaj

Kryesuesi e grupit avokus i prindërve

Hysen Avdullahu

Drejtoresha - Handikos Gjakovë

Brilanda Ballfata





Handfile 08

Forma e buxhetit

Emri i OIQ-se: Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Glavkovës "Hendikos Glavkovë"

Titulli i programit: Përkrahja e shërbimeve për Personat me Afësi të Kufizuara që ofrohen nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Handikos Glakova

[illegible]

[illegible]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KOMISIONIT PËR MBËSHTETJE FINANCIARE
PUBLIKE TË ORGANIZATAVE- JO QEVERITARE NE ZBATIMIN E AKTIVIVTETEVE
QË JANË NË DSHMS**

Sot me datë 20.07.2022 është mbajtur takimi i komisionit me qëllim të vlerësimit dhe ndarjes së subvencioneve për OJQ-të nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale sipas thirrjes publike nr.413/01-13960 të shpallur me date 31.05.2022. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesve për mbështetje financiare, komisioni vlerësoj se gjithsej kanë aplikuar dy organizata si me poshtë:

1. OJQ- HANDIKOS
2. OJQ-KMEH CAKAT 07

Ne vazhdim janë kontrolluar dokumentet dhe prioritetet e kërkuara ne bazë te thirrjes publike , me këtë raste komisioni ka konstatuar se:

OJQ- HANDIKOS- e ka te plotësuar dokumentacionin e kërkuar dhe e njëjta është përmbajtur prioriteteve sipas thirrjes publike nr.413/01-13960 te DSHMS. Me këtë rast komisioni rekomandon se i plotëson kushtet për marrjen e subvencionit në vlerë prej 20.000 euro.

OJQ-KMEH CAKAT 07- nuk i është përmbajtur kriterëve lidhur me dorëzimin e dokumentacionit të kërkuara sipas thirrjes publike nr.413/01-13960 te DSHMS te datës 31.05.2022 e njëjta refuzohet nga komisionit.

Komisioni vlerësues për thirrjen publike në fushën e shëndetësisë me numër 05-413/01-13960 në përbërje nga:

1. Blerta Qelaj Daci-kryesuese

2. Arben Hulaj-anëtar

3. Nergize Haxhiduati-anëtar

4. Berat Thaqi -anëtar

5. Vjollca Dujaka -anëtar

The block contains five handwritten signatures, each written over a horizontal line. The signatures correspond to the list of commission members provided on the left. The first signature is for Blerta Qelaj Daci, the second for Arben Hulaj, the third for Nergize Haxhiduati, the fourth for Berat Thaqi, and the fifth for Vjollca Dujaka.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KOMISIONIT PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË ORGANIZATAVE- JO QEVERTARE NE ZBATIMIN E AKTIVIVTETEVE QË JANË NË DSHMS

Sot me datë 20.07.2022 është mbajtur takimi i komisionit me qëllim të vlerësimit dhe ndarjes së subvencioneve për OJQ-të nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale sipas thirrjes publike nr.413/01-13960 të shpallur me date 31.05.2022. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesve për mbështetje financiare, komisioni vlerësoj se gjithsej kanë aplikuar dy organizata si me poshtë:

1. OJQ- HANDIKOS
2. OJQ-KMEH CAKAT 07

Ne vazhdim janë kontrolluar dokumentet dhe prioritetet e kërkuara ne bazë te thirrjes publike , me këtë raste komisioni ka konstatuar se:

OJQ- HANDIKOS- e ka te plotësuar dokumentacionin e kërkuar dhe e njëjta është përmbajtur prioriteteve sipas thirrjes publike nr.413/01-13960 te DSHMS. Me këtë rast komisioni rekomandon se i plotëson kushtet për marrjen e subvencionit në vlerë prej 20.000 euro.

OJQ-KMEH CAKAT 07- nuk i është përmbajtur kriterëve lidhur me dorëzimin e dokumentacionit të kërkuara sipas thirrjes publike nr.413/01-13960 te DSHMS te datës 31.05.2022 e njëjta refuzohet nga komisionit.

Komisioni vlerësues për thirrjen publike në fushën e shëndetësisë me numër 05-413/01-13960 në përbërje nga:

1. Blerta Qelaj Daci-kryesuese _____
2. Arben Hulaj-anëtar- _____
3. Nergize Haxhiduati-anëtar _____
4. Berat Thaqi -anëtar _____
5. Vjollca Dujaka -anëtar _____



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVË



Aplikacion për Projekt

Ju lutemi para se të plotësoni Formularin për Aplikim në Projektin në kuadër të "Thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve: që kontribuojnë në zhvillimin dhe avancimin e sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në komunën e Gjakovës", të lexoni me kujdes udhëzimet për dorëzim.

Forma duhet të plotësohet me kujdes dhe sa më qartë që të jetë e mundur në mënyrë që të mund të bëhet një vlerësim sa më i mirë i cilësisë së projekt-propozimeve. Informatat duhet të jenë të sakta, të plota në mënyrë që të japin detaje të mjaftueshme për të kuptuar në mënyrë të qartë. Ju lutem i plotësoni ato rubrika ku organizata e juaj i ka të dhënat.

Ju lutemi plotësoni formularin duke përdorur kompjuterin.

Data e publikimit të thirrjes: 31.05.2022

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit: 14.06.2022 /16:00h

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve:

-Te gjitha OJQ- te, Shoqatat e Komunes se Gjakoves programi i te cilave eshte i fokusuar ne mbështetjen e personave paraplegjik, dhe tetraplegjik.

Emri i projektit/programit: Ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara të ofruara nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet / Handikos Gjakovë

Emri i aplikuesit: Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Gjakovës "Handikos Gjakovë"

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PER SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Buniljft Qamhi, 5000 Gjakovë, Republika e Kosovës.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKUESIN E PROJEKTIT DHE PARTNERËT				
INFORMACION BAZË PËR ORGANIZIMIN E APLIKUESIT DHE DHE PARTNERËVE				
1. Emri i organizatës	Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Gjakovës "Handikos Gjakovë"			
2. Adresa (ruga dhe numri)	Rr. "Tivari" p.n.			
3. Kodi postar dhe selia	50000	4. Rajoni	Gjakovë	
5. Emri i përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së, adresa, e-mail dhe funksioni aktual (p.sh. Drejtor Ekzekutiv)	Brilanda Ballata – Drejtore Egzekutive Rr. "Latif Shaqiri" Gjakovë 50000 Kosovë brilanda.ballata@gmail.com			
6. Nr. Tel.	+383 0390 327 150	7. Nr. Tel. Mob.	+383 44 424 266	
8. Fax	+383 0390 327 150			
9. Adresa postare	50000, Gjakovë, Rr. "Tivari" p.n.			
10. Faqja e internetit	www.handikosgjakove.org  Handikos Gjakove;  handikos_gjakove			
11. Viti i themelimit	2016			
12. Data e regjistrimit në regjistrin e OJQ-ve	1 Korrik 2016	Numri i Regjistrimit të OJQ-së	5116253-6	
14. Regjistruar në (emri i organit të regjistrimit)	Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Gjakovës "Handikos Gjakovë"			
15. Numri i logarisë bankare përfshirë IBAN	Banka Kombëtare Tregtare – BKT 1930978628031191			
16. Numri fiskal	601682819			
17. Lloji i OJQ-së (shoqatë/fondacion)	Shoqatë			
18. Objektivat e krijimit në përputhje me statutin e OJQ-së	Qeverisë shoqatën jofitimprurëse, Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Gjakovës e themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës			
19. Qëllimi dhe fushëveprimi	<u>Misioni i Handikos Gjakovë:</u> Përfaqësimi dhe përkrahja e personave me aftësi të kufizuara duke avokuar dhe lobuar dhe duke ofruar shërbimet e rehabilitimit të bazuar në komunitet (RBK) për të arritur të drejta të barabarta, për një jetë të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë. <u>Fushëveprimtaria:</u> 1. Mbrojtje e personave me aftësi të kufizuara, 2. Ofrimi të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, 3. Pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike.			
20. Numri i përgjithshëm i (vendoset numëri)	Anëtarëve	822		
Nga ta (vendoset numëri)	Individ	822	Persona juridik	
21. Pjesa e punës vullnetare në organizatë	1 vullnetarë			
a) numri i atyre të cilët punojnë vullnetarisht	1 vullnetarë			

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bandit Qasha, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

b) numri i orëve të punës vullnetare arritur në vitin para shpalljes së thirrjes	20 ore në javë			
22. Numri i të punësuarve në ditën e dorzimit të projektit (vendoset numëri)	Të punësuar për kohë të kufizuar	8	Për një kohë të pacaktuar	
23. A është organizata juaj përfituese e statusit të beneficuar publik	Po.		Jo.	
24. Totali i të ardhurave të organizatës në vitin para shpalljes së thirrjes publike (vendosni shumën)	93,509.17 Euro			
25. Të ardhurat janë realizuar (shëno shumën)	77,926.46 Euro			
a) Burimet publike qendrore (ministritë dhe agjencitë qendrore qeveritare)	21,000.00 Euro			
b) Burimet publike komunale	19,752.00 Euro			
c) qeveritë e huaja dhe organizatat ndërkombëtare	18,370.00 Euro			
d) kompanitë dhe personat e tjerë juridikë	4407.17 Euro			
e) qytetarët dhe familjet	/			
f) organizatat tjera Jo-qeveritare	/			
g) të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë	/			
h) Të ardhurat nga fondet e BE-së	29,980.00 Euro			
26. Shuma totale e paguar për paga në vitin para shpalljes së thirrjes publike	55,217.74 Euro			
27. Shuma totale e paguar në të ardhura të tjera në vitin para shpalljes së thirrjes publike	31,123.71 Euro			
28. Informacion në lidhje me hapsirën në të cilën vepron OJQ				
a) Hapësira e vet (trego madhësinë në m2)	950 m2			
b) Hapësira me qira (trego madhësinë në m2)	/			
c) Hapsira e komunës/ Qeverisë/ndërmarrjes publike/ (shëno madhësinë në m2 dhe shumën e qirasë mujore)	/			
29. Shuma e përgjithshme embështetjeje financiare publike në vitin para shpalljes së thirrjes	40,752.00			
30. Numri i partneriteteve në të cilat organizata është e përfshirë në zbatimin e projekteve / programeve të aplikojnë në këtë thirrje publike	/			
31. A përgatit OJQ-ja juaj raport vjetor pune? (vendosni një "x")	Po.	x	Jo.	
a) Nëse jeni përgjigjur me "po" ku jeni është dorëzuar dhe si ia keni paraqitur publikut?	Të paktën një herë në vjet organizata i raporton kuvendit të Anëtarëve (Organizates), Donatorit, Kryetarit të Komunës, DKSHMS, DKA dhe raportet bëhen publike në faqen e organizates sonë (formë informatoriale buletini) në rrjetet sociale FB, Instagram.			

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bashki Qushi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

32. A keni shpenzuar në sistemin e cilësisë për organizatat jo-fitimprurëse?	Po.	Jo.
a) Nëse jeni përgjigjur me "po" cilin sistemin dhe deri kur?		
33. Njohja e aplikantit (apo partnerëve) përmes projekteve të financuara nga burimet publike të financimit gjatë viteve paraqitura		
(Ju lutem specifikoni projektet/ programet e financuara nga burimet publike të financimit, duke përfshirë edhe emrin e institucioneve/ofruesve të mbështetjes financiare publike nga të cilat ju keni pranur mbështetje financiare gjatë dy viteve të fundit para shpalljes së kësaj thirrje publike.		
- Drejtoria komunale e kultures rinis dhe sportit – emri i projektit “Jeta aktive II”- 2019 - Ministria e punës dhe e mirëqenies sociale - emri i projektit “Rehabilitimi i bazuar në bashkësi për fëmijëve me aftësi të kufizuara”-2019 - Program i financuar nga Kuvendi Komunal Gjakovë- emri i projektit “Përkrahja e shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara që ofrohen nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Handikos Gjakovë” -2020 - Ministria e kultures, rinis dhe sportit - emri i projektit “Përmes artit, shfaqim aftësit tona”-2020 - Ministria e Punës dhe mirëqenies sociale- emri i projektit “Ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara të ofruara nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Handikos Gjakovë” – 2020/2021 - Program i financuar nga Kuvendi Komunal Gjakovë- emri i projektit “Përkrahja e shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara që ofrohen nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Handikos Gjakovë” -2021 - MFPT në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare- emri i projektit- “Ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara të ofruara nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Handikos Gjakovë” - 2021 - Ministria e kultures, rinis dhe sportit - emri i projektit “Pjesëmarrja në jetën kulturore për personat me aftësi të kufizuara -2021		
34. Jepni informacion mbi organizatat partnere, nëse projekt/programi do të realizohet në partneritet; (nëse është e nevojshme, shtoni reshta të reja)		
1. ORGANIZATA PARTNERE (nëse është e nevojshme të shtohet më shumë informacion për partnerët)		
Emri i Organizatës:	N/A	
Adresa (ruga dhe numri):	N/A	
Qyteti:	N/A	
Rajoni:	N/A	
Emri i përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së, adresa, e-mail dhe funksioni aktual(p.sh. Drejtor Ekzekutiv)	N/A	
Telefoni fiks:	N/A	
Telefoni Mobil:	N/A	
Faksi:	N/A	
E-mailAdresa:	N/A	
Faqja e internetit:	N/A	
Viti i krijimit:	N/A	
Numri i regjistrimit të OJQ-së:	N/A	
Numri Fiskal:	N/A	

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. “Bashki Qashti, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

Data e regjistrimit në regjistrin e OJQ-ve	N/A
Lloji i OJQ-së (shoqatë/fondacion)	N/A
Objektivat e krijimit në përputhje me statutin e OJQ-së	N/A
Qëllimi dhe fushëveprimi	N/A
Numri i të punësuarve	N/A
Shuma e përgjithshme embështetjes financiare publike në vitin para shpalljes së thirrjes (si dhe numri i projekteve të financuara nga burimet publike)	N/A
Organizata vepron:	N/A
a) Hapësira e vet (trego madhësinë në m2)	N/A
b) Hapësira me qira (trego madhësinë në m2)	N/A
c) Hapësira e komunës/ Qeverisë/ndërmarrjes publike/ (shëno madhësinë në m2 dhe shumën e qirasë mujore)	N/A

II. INFORMACION MBI PROJEKTIN / PROGRAMIN

1. Emri i projektit /programit:

Ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara të ofruara nga Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Handikos Gjakovë

2. Organi i OJQ-së që ka miratuar projektin dhe data e miratimit të tij

Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Gjakovës "Handikos Gjakovë" 20/04/2022

3. Përmbledhje e projektit/programit (një prezantim i shkurtër i informacionit bazë për projektin/programin në jo më shumë se 50 fjalë)

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC) dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD) qartë theksojnë se të gjithë personat duhet të realizojnë të drejtat e tyre themelore. Të gjithë personat duhet të jenë anëtarë të plotë të shoqërisë. Personat me aftësi të kufizuara janë një nga grupet më të marginalizuara, përballë stigmës, diskriminimit dhe ndarjes në komunitetet e tyre. Ata shpesh janë të privuar nga arsimi dhe të drejtat dhe shërbimet e tjera themelore dhe janë dukshëm më të cënueshëm ndaj dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit. Analizat paraprake në këtë drejtim kanë konstatuar se personat me aftësi të kufizuara kanë mungesë të theksuar të qasjes në shërbime cilësore të bazuara në komunitet. Analizat dhe vlerësimet e kryera në Kosovë nga Save the Children, UNICEF dhe organizatat tjera dëshmojnë për mungesë të theksuar të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesë të profesionistëve të trajnuar për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe shpërndarje e pamjaftueshme të burimeve financiare shtetërore për këtë qëllim (Save the Children, 2018). Pa shërbime lokale adekuate dhe të përshtatshme, shumë familje ndihen të paaftë për të mbështetur zhvillimin psiko-social të fëmijëve të tyre, rehabilitimin fizik në shtëpi dhe përfshirjen në shkollë dhe në jetën e komunitetit (Handikos, 2018)

Handikos Gjakova mban një bazë të dhënash të gjerë për PAK, duke regjistruar 845 persona me aftësi të kufizuara të kategorizuara në informacionin mbi shëndetin dhe statutin socio – ekonomik, aftësitë, infrastrukturën etj. Handikos Gjakova veç tjerash ofron dhe këto shërbime: Vizita në shtëpi dhe referime; duke ofruar pajisje ndihmëse; duke këshilluar të rriturit me aftësi të kufizuara për vetë-kujdesje dhe jetesë të pavarur dhe po ashtu

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Hamit Qazimi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

ofron shërbime shumëdimensionale (seanca fizike dhe psiko-sociale dhe të kombinuara për fëmijët me aftësi të kufizuara etj). Edhe pse në komunën e Gjakovës operojnë një numër i madh i OJQ-ve, të pakta janë ato të cilat ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara nga të cilat kryesorja është Handikos Gjakova me numrin më të madh të anëtarëve dhe shërbimeve që i ofron për personat me aftësi të kufizuara.

Shërbimet e bazuara në komunitet për personat me aftësi të kufizuara ofrohen nga qendrat me bazë në komunitet Handikos Gjakovë nga një ekip multidisiplinar të cili dhe janë të licensuar për ofrimin e shërbimeve. Shërbimet që ofrohen në Qendrën e Handikos Gjakovës, përfshijnë një larmi programesh të hartuara për të përmbushur nevojat dhe interesat e përfituesve të shërbimit si edhe referime apo mbështetje për të përdorur shërbime të ofruara nga struktura të tjera të specializuara, me synimin përfundimtar, ofrimin në vazhdimësi të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara brenda komunitetit.

Me këtë projekt propozim, shërbimet kanë të bëjnë me përfshirjen, mbështetjen dhe avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale, kujdestarëve, prindërve dhe familjarëve të tyre për mes aktiviteteve që ofrohen në qendrën e Handikos Gjakovë. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet që ofrohen në Qendër mundësojnë fuqizimin e zërit të tyre, parandalimin dhe avancimin e gjendjes shëndetësore, zhvillimin e aftësive fizike dhe intelektuale, motivimin, ngritjen e njohurive të familjarëve mbi mundësitë dhe aftësitë e fëmijëve të tyre, socializimin, ambientimin me rrethin shoqëror. Ofrimin e shërbimeve rehabilituese, njohje dhe pjesëmarrje të plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, mbulimin me pajisje ndihmëse (karroca, kukëza, shëtitore etj), të cilat janë më se të domosdoshme për ta, dhe organizimin e aktiviteteve tjera rehabilituese me qëllim të pavarësimit të tyre për aktivitetet ditore. Ku e gjithë kjo është në funksion të realizimit të vizionit për një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje të plotë të drejtave të barabarta për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Projekti i propozuar do të jetë në gjendje të iniciojë veprimin në kohën e duhur dhe të japë rezultatet e pritshme në mënyrë efektive, duke pasur infrastrukturën ligjore taslmë në vend dhe duke bashkuar ekspertizën dhe përvojën e Handikos Gjakovës, duke garantuar efikasitetin maksimal të shërbimeve të ofruara dhe duke zbatuar praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra nga e kaluara. Duke u bazuar në bashkëpunimin me komunën, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile do të forcohet dhe bëhet më i sistematizuar, duke ndihmuar komunën që të planifikojnë dhe shpërndajnë burimet e tyre në mënyrë më efektive. Të gjitha aktivitetet e këtij e projekti do të jenë në partneritet të ngushtë me punëtorët social nga Qendra për Punë Sociale e po ashtu pjesë e së cilit do të jenë të gjitha institucionet relevante, gjë që garanton rritjen e bashkëpunimit e koordinim sa më të mirë të shërbimeve që ofrohen nga këto institucione.

Shërbimet që do ofrohen janë në kuadër të Strategjisë së Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (RBB) që orientohet nga parimi i respektimit të të drejtave, i të qenurit një ambient i hapur, i respektueshëm dhe me një sjellje të natyrës pjesëmarrëse ku mendimi i përfituesve të shërbimit kërkohet dhe merret në konsideratë. Ofrimi i shërbimeve mbështetjet në parimin për të kontribuar në ngritjen e një modeli të qëndrueshëm integrimi e zhvillimi, i cili synon të garantojë për të gjithë mundësinë e përmbushjes së nevojave bazike, si edhe një perspektivë zhvillimi të qëndrueshëm për të ardhmen.

4. Kohëzgjatja e pritur e implementimit të projektit/programit në muaj:

8 muaj

5. Fusha në të cilën do të implementohet projekti/programi (ju lutem specifikoni fushën e veprimit social dhe politikat publike në të cilat projekti/programi do të aplikohet)

- Ofrimi i shërbimeve bio psiko sociale për personat me aftësi të kufizuara;
- Ofrimi i shërbimeve në përmirësimin e shëndetit të personave me aftësi të kufizuara ;
- Përmirësimi i kushteve të jetës dhe ngritja e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara përmes ofrimit të shërbimeve shëndetësor dhe shërbimeve bio -psiko- sociale në shtëpi;

6. Rajoni gjeografik në të cilin do të implementohet projekti/programi

a) Republika e Kosovës (nëse projekti/programi implementohet në gjithë territorin e Kosovës) **N/A**

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazani, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

b) Rajoni/rajonet(tregoni rajonin ose rajonet në të cilat do të implementohet projekti	Gjakovë
c) Komunakomunat(shëno komunat përkatëse)	Komuna e Gjakovës
7. Shuma totale e kërkuar për zbatimin e projektit/programit:	20.000.00 euro
7.1 Shuma totale e kërkuar për financim nga donatorët: në ___% e shumës për implementimin e projektit/programit	N/A
7.2A është shuma e kërkuar apo e siguruar nga burimet publike (institucionet qendrore apo lokale, fondet e Bashkimit Evropian apo nga donatorë të tjerë për zbatimin e këtij projekti (specifiko shumat totale për aplikantët dhe partnerët nëse ata kanë dhe shtoni rreshta shtesë nëse është e nevojshme)	
Po.	Jo.
X	
Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është "po" tregoni se sa është kërkuar dhe miratuar nga sa çdo financim i donatorët (shtoni rreshtat e reja nëse është e nevojshme):	
Nga ata që është kërkuar:	Shuma e fondeve të kërkuara:
Nga ata që është siguruar	Shuma e fondeve të miratuara:
B. Ju lutem tregoni mënyrën se si keni ardhur deri tek identifikimi i problemit dhe vlerësimi i nevojave që keni ndërmend të adresoni përmes këtij projekti, bazuar në të cilat ju keni përgatitur këtë propozim të projektit/programit?	
Handikos Gjakovë ka një përvojë të gjatë dhe solide në ofrimin e shërbimeve, duke ofruar shërbime të përgjithshme të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (RBB) që nga viti 1999, në të cilat ka pilotuar dhe ofruar një sërë modelesh të shërbimeve sociale të bazuara në bashkësi, duke ofruar shërbime në qendër (fizioterapi, ergoterapi, mbështetje psiko-sociale, keshilla psikologjike, shërbime shëndetësore, edukim-joformal), duke bërë vizita në shtëpi dhe referime, duke ofruar pajisje ndihmëse, duke kështilluar kujdestarët, e të rriturit me aftësi të kufizuara për vetë-kujdes dhe jetesë të pavarur dhe është e vetmja organizatë në komunë e cila ofron me profesionalizëm shërbime cilësore dhe mjete ndihmëse sipas nevojës për persona me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për shërbime shëndetësore, sociale e integruese gjatë zhvillimit të tyre dhe gjatë tërë jetës së tyre e ku janë të dokumentuara mirë në Kosovë. Një nga nevojat më urgjente është tejkalimi i qasjes mbizotëruese bëmirese, e cila i sheh personat me aftësi të kufizuara si "pranues pasivë të kujdesit" - evident në të gjithë sektorët në Kosovë. Në shoqërinë Kosovare, personat me aftësi të kufizuara tentojnë të perceptohen në kuptim të vështirësive të tyre dhe jo të theksojnë potencialin e tyre për të kontribuar dhe pasuruar shoqërinë. Prandaj, qasja bëmirese - megjithatë me qëllim të mirë - mund të forcojë problemet me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara dhe të kufizojë lëvizshmërinë e tyre sociale. Ata mbeten si të huaj në shoqëri. Pavarësisht disa përmirësimeve, ngjashëm me vendet e tjera në rajon, Kosova vazhdon të përballlet me mangësi në aspektin e disponueshmërisë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve me bazë në komunitet i për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale. Qendra e rehabilitimit e bazuar në komunitet - Handikos Gjakovë, është financuar, për programin e Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi për fëmijët me aftësi të kufizuara për 3 vite (2016-2018) nga Fondacioni Margaret A. Cargill Philanthropy (MACP) të implementuar në partneritet me Save the Children International në Kosovë. Ky fondacion ka mbështet 5 shtete rajonale Shqipërin, Armenin, Gjeorgjin, Kosovën dhe BiH, për krijimin dhe operimin e 10 qendrave të bazuara në komunitet. Në vitin 2018 -2019 është mbështetur projekti "Shërbime në familje për të rritur me aftësi të kufizuara", nga Bashkimi Evropian në Kosovë me bashkëfinancim nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), projekt i implementuar nga Handikos Gjakovë, mbështetur nga Save the Children në Kosovë dhe Qendra Evropiane për Politika dhe Hulumtime të Mirëqenies Sociale. Po ashtu nga viti 2020 kemi marrëveshje bashkëpunimi dhe mbështetje të programit edhe nga Kuvendi Komunal Gjakovë si dhe suvencionimin e vazhdueshme nga MPMS. Programet që kemi implementuar kanë arritur të bëjnë ndryshim në ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara edhe në Kosovë, duke ofruar një model të shërbimeve nga qendra jonë në Gjakovë të cilat shërbime kanë qenë të mbështetura në parimin për të kontribuar	

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazimi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

në ngritjen e një modeli të qëndrueshëm integrimi e zhvillimi, i cili synon të garantojë për të gjithë mundësinë e pëmbushjes së nevojave bazike, si edhe një perspektivë zhvillimi të qëndrueshëm për të ardhmen.

Qëllimi përfundimtar i modelit ekzistues, duke theksuar rëndësinë dhe arsyetimin e këtyre shërbimeve, ishte që të sigurojë vazhdimësi të implementimit dhe financim të qëndrueshëm. Marrë parasysh gjendjen e përgjithshme socio-ekonomike në Kosovë dhe numrin e madh të kategorive në nevojë për mbështetje, e për vazhdimin e ofrimit të shërbimeve dhe modelit të programit të RBB, financimi nga skemat shtetërore mbetet opcioni më i qëndrueshëm. Në rastin e qendres RBB në Gjakovë, shteti/komuna ka trashiguar shërbime cilësore të themeluara dhe punonjës të përgatitur dhe profesional për të ofruar këto shërbime, të cilat janë edhe alternativa e vetme e ofruar për personat me aftësi të kufizuara e po ashtu ka trashiguar edhe qendren e re me bazë në komunitet me standarde. Modelet rajonale dhe ndërkombëtare qartazi e dëshmojnë që qëndrueshmëria e vetme e këtyre shërbimeve është kontraktimi nga mekanizmat shtetëror.

9. Lista e përshkruajnë objektivat e synuara të arrihet përmes zbatimit të projektit / programit të propozuar.

- Ofrimi i shërbimeve lokale duke përmirësuar mbulimin, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve sociale me bazë komunitare, kujdesit, asistencës personale, shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet krijimit të shërbimeve shumëdimensionale të bazuara në shtëpi për të rriturit me aftësi të kufizuara.
- Të mbështeten kujdestarët/ familjet të bëhen reziliente dhe në gjendje për të lehtësuar zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor të personave me aftësi të kufizuara dhe të avokojnë për të drejtat e tyre për arsimim, shëndetësi dhe përfshirje sociale.

10. Përshkruani ndikimet e pritshme të projektit/programit –atë se si projekti do të ndikojë në grupin e synuar dhe përdoruesit përfundimtarë në një periudhë afatgjate.

Projekti i propozuar do të jetë në gjendje të iniciojë veprimin në kohën e duhur dhe të japë rezultatet e pritshme në mënyrë efektive, duke pasur infrastrukturën ligjore tashmë në vend dhe duke bashkuar ekspertizën dhe përvojën e Handikos Gjakovës, duke garantuar efikasitetin maksimal të shërbimeve të ofruara dhe duke zbatuar praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra nga e kaluara, duke u bazuar në bashkëpunimin me komunën, dhe në fund të projektit, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile do të forcohet dhe bëhet më i sistematizuar, duke ndihmuar komunën që të planifikojnë dhe shpërndajnë burimet e tyre në mënyrë më efektive. Të gjitha aktivitetet e këtij projekti do të jenë në partneritet të ngushtë me qendrën për pune sociale, qendrat e mjekësisë shëndetësore, e po ashtu do të jenë të gjitha institucionet relevante, gjë që garanton rritjen e bashkëpunimit e po ashtu koordinim sa më të mirë të shërbimeve që ofrohen nga këto institucione.

11. Përshkruani rezultatet e matshme që ju i prisni në fund të zbatimit të projektit/programit tuaj.

Rezultati ynë ka për qëllim që të rrisë numrin e personave me aftësi të kufizuara që përdorin shërbime të integruara në qendrën e Rehabilitimit të bazuar në komunitet në Gjakovë, të zhvillojnë aftësitë e tyre, të praktikojnë pavarësinë dhe të gëzojnë përfshirjen.

Rezultati

Krijimi i një mjedisi mbrojtës, të mundshëm dhe gjithëpërfshirës, duke ofruar shërbime dhe udhëzime të specializuara dhe të orientuara nga nevojat për personave me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, duke përmirësuar mirëqenien e tyre sociale integrimin dhe ofrimin e shërbimeve që aktualisht nuk janë të disponueshme ose të arritshme.

Rezultati 1

Permisimi i jetës psiko sociale e shëndetësore të 30 personave me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Banfilj Qazuli, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

Rezultati 2

Permisimi i jetës sociale të 30 familjareve/kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuar

12. Shpjegoni se në arritjen e cilave objektiva të përgjithshme dhe specifike të thirrjes publike do të kontribuojë implementimi i këtij projekti dhe si.

Veprimi i propozuar është në përputhje me prioritetet e paraqitura dhe objektivat e paraqitura në udhëzimet duke kontribuar në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për grupet më të cënueshme, përfshirë këtu të rinjtë dhe personat në nevojë. Projekti është plotësisht në përputhje me objektivat e kësaj thirrje, në veçanti në Objektiven: Shërbime të rehabilitimit dhe trajtimit për personat me nevoja të veçanta fëmijë dhe të rritur (të verbërit, të shurdhër, tetraplegjike, paraplegjike, me down sindrom, autizem etj). Shërbime të mbrojtjes, këshillimeve psiko-sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.

13. Një përshkrim i detajuar i projektit/programit (max 2500 karaktere)

Ky projekt ka të bëjë me përkrahjen e Qendrës me bazë në Komunitete Handikos Gjakovë, në përfshirjen, mbështetjen dhe avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale, kujdestarëve dhe familjarëve të tyre për mes shërbimeve/aktivitetet që ofrohen nga qendren e Handikos Gjakovë. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet që ofrohen në qendrën e Handikos Gjakovë mundëson fuqizimin e zërit të tyre, parandalimin, preventimin dhe avancimin e gjendjes shëndetësore, zhvillimin e aftësive fizike dhe intelektuale, motivimin, ngritjen e njohurive të familjarëve mbi mundësitë dhe aftësitë e personave me aftësi të kufizuara rreth socializmit, ambientimit me rrethin shoqëror dhe integrimin e përgjithshëm të tyre në shoqëri. Ofrimin e shërbimeve rehabilituese, njohjes dhe pjesëmarrje të plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, mbulimin me pajisje ndihmëse (karroca, kukëza, shëtitore etj) për personat me aftësi të kufizuara, të cilat janë më se të domosdoshme për ta, e të cilat ofrohen vetëm nga organizata jonë.

Si përmbledhje, shërbimet do ofrohen sipas programit të Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet dhe ndahen në:

1. Shërbime të drejtpërdrejta për personat me aftësi të kufizuara:

- a) Vlerësime profesionale të nevojave, aftësive dhe shkathtësive (përmes vizitave familjare dhe punës në qendër) përmes programit të Menaxhimit të rastit
- b) Terapi individuale dhe grupore, terapi të artit dhe lojës;
- c) Programe të specializuara si: (metodologjia HEART, programi PORTIGJ – Identifikimi në fëmijërin e hershme, programe edukative, programe për fuqizimin e komunikimit, programe të motorikës fine dhe grose, programe të modifikimit të sjelljes, programe të autonomisë personale, për jetesë të pavarur, etj);
- d) Këshillim mjekësor, psikosocial, edukativ dhe ligjor;
- e) Rehabilitim primar fizik, psikosocial dhe mendor;
- f) Parandalimi i pasojave si rezultat i aftësisë së kufizuar;
- g) Pajisje ndihmëse;
- h) Shërbime për jetesë të pavarur;
- i) Shërbime individuale terapeutike, mbështetëse, edukative dhe informuese në shtëpinë ku jeton përfituesi;

2. Mbështetje dhe ngritje të kapaciteteve të familjarëve të përfituesve:

- j) Informim dhe këshillim;
- k) Këshillim familjar;
- l) Mbështetje në avokim;
- m) Motivim dhe inkurajim të personave me aftësi të kufizuara dhe kujdestarëve përmes takimeve konsultative individuale dhe grupore;
- n) Organizim të takimeve të rregullta grupore me qëllim të shkëmbimit të përvojave;

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazazi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

o) Përkrahje dhe monitorim të aktiviteteve të cilë duhet ti kryejnë në shtëpitë e tyre.

14. Cili është grupi i synuar (grupi në të cilin aktivitetet e projektit/programit do të ndikojnë direkt) i përfshirë në projekt, duke përfshirë numrin dhe strukturën e tyre (p.sh., moshë, gjinia, etj)? Si janë ata të përfshirë në këtë projekt? (Ju lutem specifikoni problemet dhe nevojat e grupeve të synuara, duke përfshirë edhe treguesit sasiorë dhe se si projekti do të arrijë grupin e synuar)

Përfutuesit primar të shërbimeve të bazuara në bashkësi janë 30 persona me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, prej të cilëve 20 do të jenë persona me aftësi të kufizuara, fokus tek fëmijët me aftësi të kufizuara 0-15 të cilët janë në gjendje të rënd dhe me pamundësi lëvizje jashtë shtëpisë dhe do ju ofrohen shërbime të rehabilitimit shëndetësor dhe psiko-social në qendrën e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Handikos Gjakovë dhe shërbime në shtëpi. Veprimi do të mbështesë personat me aftësi të kufizuara në drejtimin e jetës së barabart, të shëndetshme dhe të pavarur, duke trajtuar forma të ndryshme të nderprivimit, të cilat shërbimet aktuale lokale nuk janë në gjendje të kapin dhe të trajtojnë dhe duke mbështetur anëtarët e familjes dhe kujdestarët në rolet e tyre kërkuese.

Po ashtu të adoleshentët dhe të rinjtë të grup moshës 14-29 vjeq do jenë të involvuar në punëtorit egzistuese që kemi në qendër (sera aqua ponie, kopshtin me erza e lule dhe punëtorin me punime dore si korniza të fotografive, piktura, pako dekorative etj.) programet të ndërmarrjeve të vogla sociale, ku të gjitha produktet janë në shitje, e mjetet e fituara nga shitja e këtyre produkteve një pjesë do të shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve që do të realizohen nga grupi i të rinjve në bashkëpunim me Handikos Gjakovë me mundësin e pagesen e të rinjve për punën e bërë.

15. Kush janë përfutuesit përfundimtarë të projektit (individët, grupet, organizatat që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit, por që implementimi i projektit do të ketë tek ata një efekt të tërthorë)? Si do të ndikojë projekti tek ato grupe? (Ju lutem specifikoni):

PËRFUTUESIT DIREKT 30 persona me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të të gjitha kategorive, (paraplegjik, tetraplegjik, paraliz cerebrale, distrofi, spina bifida, autizem, down syndrom, prapambetje mendore etj..)

PËRFUTUESIT INDIREKT: 30 Familjar/ kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara

16. Përshkruani, aktivitetet kryesore që do të kryhen në kuadër të projektit, bartësit, rezultatet e pritura, periudha e zbatimit të tyre, metodat që do të përdoren në zbatimin e projektit (nëse është e nevojshme shtoni reshta në tabelën e mëposhtme).

Aktivitetet	Bartësi	Metodat implementuese	Periudha e implementimit	Rezultatet e pritura
1. 1.1 Identifikimi dhe përzgjedhja e përfutuesve të programit	Kordinator/ja e shërbimeve dhe Stafi i projektit	Identifikimi i përfutuesve potencial. Përfutuesit potencialë do të zgjidhen nga baza e të dhënave të cilat i disponon Handikos Gjakovë, duke pranuar edhe referencat nga punëtorët social të Qendrës për Punë Sociale dhe sipas nevojës plotësohet numri i përfutuesve duke u dhënë përparësi personave: Po ashtu një pjesë e përfutuesve do të identifikohen nga hulumtimi i cili do të bëhet në vazhdimi në teren me qëllim identifikimin e PAK.	Muaji i parë i projektit	Si rezultat i projektit janë identifikuar 30 përfutues potencial

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bashkëpunimi", 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

1.2 Vlerësimi i nevojave	Kordinator/ja e shërbimeve Ekipi multi disiplinar i Handikos Gjakovë	Vlerësimi holistik i personave me aftësi të kufizuara duke u bazuar në qasjen bio-psiko-sociale.	Muaji i parë i projektit	Vlerësimi i nevojave të 30 përfituesve të cilat janë përshtaten më pas me programin e propozuar. Nevojat e përfituesve janë vlerësuar përmes Kartelave të Vlerësimit të ndara për të rritur të cilat kanë për qëllim të matin nivelin e zhvillimit me bazë holistike tek personat me aftësi të kufizuara.
1.3 Planifikimi individual për shërbime	Kordinator/ja e shërbimeve Stafi i projektit	Përpilimi i Planeve Individuale të Intervenimit bazuar në rekomandimet e vlerësimit, observimit të rastit dhe perspektives së rastit.	Muaji i parë i projektit dhe rrvlerësimi odo tre muaj	Janë përpiluar 30 plane individuale e po ashtu janë vlerësuar e ri-vlerësuar për të arriturat e tyre në kuadër të shërbimeve të pranuar, ku më pas do gjenerohet një raport individual i intervenimit duke përcaktuar objektiva të përbashkëta me vetë ta si dhe familjarin përgjegjës. Plani do të monitorohet përmes raportimit individual për çdo përfitues.
2. Mbështetje sociale	Puntor social / Zyrtar për mbrojtjen e PAK-ve	Menaxhimi i Rastit dhe Këshillim. Do punohet për identifikimin e familjeve dhe personave me aftësi të kufizuara, planifikimin e vizitave në familje ku do merren të dhënat do diskutohen nga ekipi multidisiplinar sipas programit të këshillimit dhe menaxhimit të rastit për zgjidhjen e problemeve sociale, ekonomike, familjare etj. Do mbahen seanca (individuale dhe grupe) informuese për shërbimet që ofrohen për personat me aftësi të kufizuara dhe për përdorimin më të mirë të këtyre shërbimeve; angazhim dhe mobilizim të institucioneve relevante dhe komunitetit për krijimin e fondeve dhe burimeve të duhura për të adresuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara për përfshirje sociale; avokim dhe lobim për përmirsim të shërbimeve me cilësi të ofruara.	Muaji i parë i projektit deri në përfundim të projektit	Rezultati 1: Rifreskimi i databazës së PAK-ve në komunën e Gjakovës Rezultati 2: Pozita e përmirësuar sociale e 30 personave me aftësi të kufizuara. Rezultati 3: Njoftimi i 30 familjeve Prindër/Kujdestar mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara Produkti 1: Plotesimi i pyetësoreve (instrument) me të dhëna të rrateve të reja dhe rivizitave. Produkti 2: Plotesimi i 30 pyetësoreve (instrument) për menaxhimin e rastit. Produkti 3: Numri i përfituesve të informuar lidhur me shërbimet pas regjistrimit të tyre në databazë
3. Asistencë në shtëpi për vetëkujdesje dhe	Ergoterapist/fizioterapist	Asistim për individin për zhvillimin e shkathëtsisë si dhe të	Muaji i gjashtë i projektit deri në	Rezultati 1: Përmirësimi i cilësisë së kohës së lirë i 10

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Ujvali, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

pavarësim për aktivitete ditore		shfrytëzimin e kapacitetit ekzistues, këshillon dhe ndihmon personin për vetëkujdesje dhe aktivitete ditore si ushtrime të lëvizjes, pastrim, larje, gatim etj., me qëllim të pavarësimit të tij për aktivitete ditore. Ofrimi i shërbimeve këshilla për pozita dhe fizioterapi primare në familje në mënyrë që të plotësohen nevojat fizike të individëve, këshillojnë familjare dhe shërbime psiko - arsimore për forcimin e familjes dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara. Në kuadër të këtij aktiviteti do të angazhohen në baza vullnetare edhe studentë/apsolventë të ketyre fushave (Ergoterapeut , Fizioterapeut).	perfundim të projektit	personave aftësi të kufizuara duke ofruar shërbimeve të rregullta të ergo - fizioterapisë. Rezultati 2: Pozita e përmirësuar sociale e 10 personave me aftësi të kufizuara. Rezultati 3: Pozita e përmirësuar sociale dhe ngritje të kapaciteteve e 10 familjeve / kujdestarëve të persona me aftësi të kufizuara
4 Aktivitete psikosociale / kreative dhe rekreative	Puntor/e psikosociale & Asistent/e i Bibliotekës së lodrave	Ka për qëllim përmirësimin komunikimit, koncentrimin dhe stimulimin e tyre fëmijëve. Parapërgatitjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara për tu kyçur në sistemin shkollorë, zhvillimi i edukimit joformal pas orëve të mësimin për arsimin mbështetës, shërbimit e kujdesit dhe mbështetjes me bazë në shtëpi për fëmijët që nuk janë fizikisht në gjendje të vijnë qendrën apo shkollën, Zhvillon aktivitetet në librarinë e lodrave për fëmijët me aftësi të kufizuara; Përmes lodrave ndihmon fëmijët me aftësi të kufizuara për të mësuar; Ofron terapi të fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes lodrave; Ofron terapi për nevoja jetësore dhe jetë sa më të pavaruar për fëmijët me aftësi të kufizuara përmes lodrave të improvizuara si pajisje shtëpiake në ofrimin shërbimeve në shtëpi ; Aktivitetet argëtuese që promovon përfshirjen sociale dhe pavarësinë, motivimin i prindërve për të përkrahur edukimin shkollorë të fëmijëve të tyre. Do mbahen takime grupore në Qendrën e Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet po ashtu dhe aktivitete në natyrë dhe vizita të ndryshme.	Muaji i parë i projektit deri në perfundim të projektit	Rezultati : Mbatja e takimeve e aktiviteteve në punëtori 2 her në javë Rezultati : Shërbimet të tilla si aktivitetet individuale dhe grupore, me adoleshent me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, do të përfshihen për të maksimizuar integrimin fizik, emocional, njohës dhe social të rinjve me aftësi të kufizuara, të rinjtë do të përfitojnë ndërgjegjësim më të madh në lidhje me sjelljen sociale, menaxhimin e emocioneve dhe zemërimin në trupat e tyre, si dhe rritjen e vetëbesimit. Rezultati: Argëtimi dhe menaxhimi i kohës së lire të PAK

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Iskryll Qaulia, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

5. Shërbime të komunikimit	Logopedia	Terapia e logopedisë është për të gjithë fëmijët që kanë vështirësi në komunikim dhe që me tinguj të thjeshtë arrijnë të komunikojnë një dëshirë apo një nevojë të tyre. Pas një inventari të hollësishëm nga logopedja të tingujve dhe fjalëve të fëmijës, hartohet programi edukativ gjithësesi vetëm për komunikimin. Zakonisht bëhet tepër i detajuar me imitime, kërkesa, përfundime, etj..	Muaji i parë i projektit deri në përfundim të projektit	Rezultati 1: Përmirësimi i komunikimit të 10 personave aftësi të kufizuara duke ofruar shërbime të rregullta të logopedisë. Rezultati 2: Pozita e përmirësuar sociale e 10 personave me aftësi të kufizuara.
6. Edukim jo-formal	Edukatorja jo-formal	Ofrojnë shërbime pesë ditë në javë si lehtësimi i procesit të regjistrimit në shkollat e zakonshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara, mbështetjen dhe monitorimin e përfshirjes së tyre dhe rezultateve të të nxënës; zhvillimi i edukimit joformal për përgatitje për regjistrim në shkollë; zhvillimi i edukimit joformal pas orëve të mësimi për arsimim mbështetës; shërbimin e kujdesit dhe mbështetjes me bazë në shtëpi për fëmijët që nuk janë fizikisht në gjendje të vijojnë qendrën apo shkollën; sipas Programit të Intervenimit të Hershëm-Portage. Programi përfshin regjistrimin e rregullt të reagimeve mbështetëse përparimin e fëmijës dhe hapat e ardhshëm që duhet të ndërmirë. (Programi Portage është dizajnuar për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve të moshës parashkollore në mjedisin e shtëpisë përmes ndërtimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të prindërve të tyre). Fuqizon familjet dhe mbështet prindërit bashkëpunimi me ekipin e vlerësimit komunal dhe bashkëpunimi në mes të institucioneve të	Muaji i parë i projektit deri në përfundim të projektit	Rezultati 1: Ofrimi i shërbimeve të rregullta të Intervenimit të Hershëm-Portage për 5 fëmijë. Rezultati 2: Ofrimi i shërbimeve të rregullta përgatitje për regjistrim në shkollë; zhvillimi i edukimit joformal pas orëve të mësimi (në qendër) për 5 fëmijë. Rezultati 3: Pozita e përmirësuar psikosociale edukative e 10 fëmijëve me aftësi të kufizuara Rezultati 4: Familjarët /kujdestarët kanë përfituar nga ngritja e kapaciteteve që kanë për qëllim lehtësimin e zhvillimit të sjelljes, edukimit psikosocial të fëmijëve të tyre në mjediset e shtëpisë. Rezultati 4: Mbatja e 3 Aktiviteteve kreative dhe rekreative që promovojnë përfshirjen sociale dhe pavarësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHëndETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazimi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

		shëndetësisë, arsimi dhe shërbimeve sociale, për të forcuar kapacitetin e tyre të bashkëpunimit dhe mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve në nevojë.		
7. Shërbimet e transportit në teren dhe të përfuturave me aftësi të kufizuara dhe Ofrimi dhe shpërndarja e mjeteve ndihmëse	Vozitës/Logjistika	Ofron shërbime për nevojat e Qendrës gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit dhe nevojave tjera të Qendrës dhe stafit. Kryerja e transportit për punën në terren: shërbimet, vizitat, këshillat. Pranon kërkesat për mjetet ortopedike, shpërndarjen e pajisjeve ndihmëse drejtpërdrejt në shtëpi. Mbulimi i nevojave të PAK-ve me pajisje ndihmëse (karrocave për fëmijë dhe të rritur, karroca të tualetit, kukëzave dhe paterica, jastëk antidekubitar, etj.); Referim për mjetet asistuese (proteza, orteza, karrike speciale, tavolin speciale, lugë speciale duke përfshirur nevojat e personit me aftësi të kufizuara etj.) Mbajtja e evidencës të ofrimit të mjeteve ortopedike sanitare/ regjistrimi i mjeteve ortopedike e sanitare.	Muaji i parë i projektit deri në përfundim të projektit	Rezultati 1: 30 persona përfutur të shërbimeve
8. Trajnim me prindër	Ofruesit e shërbimeve	Trajnime për prindër – ofrimi i trajnimeve dhe seancave edukimi për prindërit / kujdestarët në mënyrë që ata të përfitojnë kompetenca specifike për kujdesin primar dhe edukimin e fëmijës së tyre.	Muajin e tretë dhe Gjashtë	Rezultati : Ngritja e kapaciteteve dhe përgatitja e prindërve për mbështetjen e fëmijëve të tyre në rehabilitim në kushte të shtëpisë.
17. Listoni aktivitetet më të shpeshta që kryhen në projekt/program.				
- Mbështetje sociale - Ofrimi i shërbimeve në ergo/ fizo- terapi - Ofrimi i shërbimeve në mbështetje bio-psiko-sociale, edukim joformal - Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të logopedisë - Ofrimi i shërbimeve me pajisje ndihmëse dhe me materiale sanitare - Fuqizimi i familjeve/kujdestarëve, për të lehtësuar zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor të PAK-ve, të avokojnë për të drejtat e tyre.				

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazuli, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

- Aktivitete rehabilituese kreative dhe rekreative

18. Ju lutem tregoni se cili lloj i aktiviteteve të tjera do të kryhet në kuadër të projektit/program.

Shërbime të drejtpërdrejta për personat me aftësi të kufizuara

- Programe të specializuara (metodologjia HEART, programi Portigj – programi i bibliotekës së lodrave , programe edukative, programe për fuqizimin e komunikimit, programe të motorikës fine dhe grose, programe të modifikimit të sjelljes, programe të autonomisë personale, për jetesë të pavarur, etj)
- Pajisje me mjete ndihmëse, material sanitar dhe inkontinenc
- Shërbime për jetesë të pavarur
- Shërbime individuale terapeutike, mbështetëse, edukative dhe informuese në shtëpinë ku jeton përfutuesi
- Organizim i trajnimit grupor me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritje të kapaciteteve të rinjeve

Mbështetje dhe ngritje të kapaciteteve të familjarëve të përfutuesve

- Informim dhe këshillim
- Mbështetje në avokim
- Motivim dhe inkurajim të kujdestarëve përmes takimeve konsultative individuale dhe grupore
- Përkrahje dhe monitorim të aktiviteteve të cilat kujdestarët duhet ti kryejnë në shtëpitë e tyre, modifikimi i pasiveve në shtëpi ndërtimi i ulëseve speciale, referencat ortopedike, etj.

19. Plani i veprimit - të sigurojë emrin e aktiviteteve dhe të nxjerrë në pah, kur do të zbatohet aktiviteti dhe organizata që është përgjegjëse për zbatimin e tij (organizata aplikuese, ose partnerët) (nëse është e nevojshme, zgjeroni tabelën).

Giysma e parë e projektit

Aktiviteti	Muaji i zbatimit	1	2	3	4	5	6	Organizata përgjegjëse
Aktiviteti	Muaji i zbatimit	7	8	9	10	11	12	Organizata përgjegjëse
Aktiviteti 1.	Muaji i parë	X						Handikos Gjakovë / Kordinator/ja e Shërbimeve / Stafi i projektit
1.1 Identifikimi dhe përzgjedhja e përfutuesve të programit								
Aktiviteti 2		X						Handikos Gjakovë - / Kordinator/ja e Shërbimeve / Ekipi multi disiplinar
1.2 Vlerësimi i nevojave								
Aktiviteti 3.		X				X		Handikos Gjakovë Kordinator/ja e Shërbimeve / Stafi i projektit
1.3 Planifikimi individual për shërbime								
Aktiviteti 4.		X	X	X	X	X	X	Handikos Gjakovë/ Puntor Social
Mbështetje social								
Aktiviteti 5.		X	X	X	X	X	X	Handikos Gjakovë/ Ergoterapist/fizioterapist

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bashkyl Qazimi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

2Asistencë në shtëpi për vetëkujdesje dhe pavarësim për aktivitete ditore								
Aktiviteti 6. Aktivitete psikosociale / kreative dhe rekreative		x	x	x	x	x	x	Handikos Gjakovë / Puntor/e psikosociale & Asistent/e i Bibliotekës së lodrave
Aktiviteti 7. Aktivitete kreative dhe rekreative		x		x			x	Handikos Gjakovë / Puntor/e psikosociale & Edukator/ja jo-formal
Aktiviteti 8. Shërbime të komunikimit		x	x	x	x	x	x	Handikos Gjakovë / Logoped/ja
Aktiviteti 9. Edukim jo-formal		x	x	x	x	x	x	Handikos Gjakovë / Edukator/ja jo-formal
Aktiviteti 10. Ofrimi dhe shpërndarja e mjeteve ndihmëse		x	x	x	x	x	x	Handikos Gjakovë/ Ekspert/Logjistika
Aktiviteti 11. Shërbimet e transportit në teren dhe të përfuturave me aftësi të kufizuar dhe mbikqyrës i serës Aqua ponc		x	x	x	x	x	x	Handikos Gjakovë/ Vozitësi
Aktiviteti 11. Trajnimi për kujdestarët/prindërit		x			x			Handikos Gjakovë Kordinator/ja e Shërbimeve / Staf i projektit
20. Personat përgjegjës për zbatimin e projektit / programit								
a) Udheheqesi/drejtuues i projektit / programit (shkruani emrin dhe bashkangjiti një CV)	Brilanda Ballata – Drejtoresh e Organizatës CV e bashkangjitur							

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazuli, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

b) Kontraktorët (shkruani emrin, përshkrimin e përvojës dhe kualifikimeve të mëparshme)

Kordinatore e shërbimeve- Edukatore jo-formale-Ilirijana Luzha

Shkolla e mesme, Qendra Matematike Natyrore "Hajdar Dushi" Gjakovë të degës shëndetësore –Motër medicinale teknike. Përvoja e punës: Spitali Regional: "Isa Grezda" reparti Neuropsikiatrik 1991-1994. Në qendrën e Rehabilitimit Të Bazuar në Bashkësi OJQ "Handikos" nga muaji Korik i vitit 2000 punon me fëmijë aftësi të kufizuara duke ofruar shërbime të fizoterapis primare dhe fizoterapi të alternativa të tjera dhe edukatore joformale në qendrën e Handikos Gjakovë dhe vazhdon. Ka trajnime të shumta të programit të rehabilitimit të bazuar në bashkësi.

E licensuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale – Përkujdesje për higjienën e klientit/Përkujdesje për për nevojat jetësore Nr.i Licenses-067/14R dhe nga Ministria e Shëndetësisë –Infermiere e përgjithshme Nr.i Licences: KO-15896-05-20.

Punëtor/e social - Arber Xharra- BA në Administratë Publike dhe marrëdhënie

ndërkombëtare në Universitetin "Universum". Ka rreth 20 vite përvojë në shoqërinë civile ku fillimisht ka filluar angazhimin e tij si vullnetar në sektorin e rinisë në Gjakovë, më pas Arbëri ka qenë kryetari i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal të Gjakovë, Drejtor i Qendrës Rinore Gjakovë dhe nga viti 2017 – 2021 ka ushtruar detyrën e zyrtarit të mbrojtjes së të drejtave dhe qevesisjes me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kuadër të organizatës HANDIKOS. Po ashtu Arbëri është i angazhuar në Handikos Gjakovë si punëtor social/Zyrtar për mbrojtjen e fëmijëve. Vlen të theksohet se Arbëri ka një numër të madh të trajnimeve të përfunduara në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Ergoterapist/fizioterapist/e Leoarda Alija Shkolla e mesme e Mjeksisë "Hysni

Zajmi" Gjakovë të degës shëndetësore – Motër Pediatrike. **Përvoja e punës:** Spitali Regional : "Isa Grezda" Reparti Fizioterapi 01.06-31.12.1999. Në qendrën e Rehabilitimit Të Bazuar në Bashkësi OJQ "Handikos" nga muaji Korrik i vitit 2000 punon me fëmijë aftësi të kufizuara duke ofruar shërbime të fizoterapis primare dhe fizoterapi të alternativa të tjera në qendrën e Handikos Gjakovë dhe vazhdon edhe tani. Ka trajnime të shumta të programit të rehabilitimit të bazuar në bashkësi.

E licensuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale – Përkujdesje për higjienën e klientit/Përkujdesje për shëndetin e klientit. Nr.i Licenses-045/18R dhe nga Ministria e Shëndetësisë – Moter pediatrike Nr.i Licences: KO-15395-05-22.

Punëtor/e psikosociale & Asistent/e i Bibliotekës së lodrave Qendresa Kadrigeli

Sociologe e diplomuar, Programi Master-Sociologji në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, Përvoja e punës ...Në OJQ "Handikos Gjakovë", Koordinatorë e programit/Asistente sociale, Mars /2018 deri shtator 2019, Këshilluese psiko-sociale në sektorin psiko-social në OJQ- "Medica Kosova", 17/01/2011 – 31/12/2015, ... Praktikante, 13/12/2010 – 21/01/2011, Qendra për punë sociale, Organi i Kujdestarisë, Gjakovë, E Licensuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, për ofrim të shërbimeve, Niveli Superior.

Logoped/e Genita Shehu - Bachelor i Logopedisë, Kolegji Heimerer – Kampusi

Gjermano-Kosovar për Arsimit dhe Karrierë në Shëndetësi. Përvoja e punës: Në OJQ "Handikos Gjakovë" Logopede, 01.06.2020 - 31.12.2020 vazhdon ...si dhe ka shumë trajnime. E LICENSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSIS –TERAPI E SPECIALIZUAR LOGOPEDI, E Licensuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, për ofrim të shërbimeve, Niveli Superior.

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazimi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

	<u>Vozitësi/ Logjistika – Ahmet Binaku</u> - ka të përfunduar shkollën e mesme Akademia pedagogjike "Hysni Zajmi" në Gjakovë. Ahmeti ka një përvojë të gjatë të punës me angazhimin e tij në organizata të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare. Ahmeti që nga viti 2011 është angazhuar në Handikos dhe Handikos Gjakovë. Përvoja e tij e gjatë në Handikos Gjakovë ka bërë që të ndjekë një numër të madh të trajnimeve mbi temat e aftësisë së kufizuar e po ashtu të jetë profesionist dhe i devotshëm në realizimin e punëve të tij. E Licensuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, për ofrim të shërbimeve, Niveli Bazik.
21. Numri i vullnetarëve që marrin pjesë në projekt / program (specifikoni numrin e vullnetarëve dhe numri i orëve vullnetare të parashikuara në projekt / program)	N/A
22. Përshkrimi i aktiviteteve të cilat vullnetarët do të kryejë për zbatimin e projektit (për secilin kategori dhe llojin e punës vullnetare)	N/A
23. Numri i personave të punësuar të përfshirë në zbatimin e projektit / programit (specifikoni për të gjitha organizatat)	6 persona për ofrim të shërbimeve sociale, 2 person në menaxhim dhe administrat /dhe 1 mirëmbajtës Handikos Gjakovë. Gjithsejt: 9 persona Handikos Gjakovë
24. Ekspert /et, bashkëpunëtorët / e jashtëm të cilët janë përfshirë në projekt / program (shëno emrin dhe fushat e ekspertizës)	N/A
25. Përshkrim i shkurtër i përvojave, amiteve dhe aftësitë e organizatës - aplikanti në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me partnerin. (specifiko aktivitete/projekteve / programeve të mëparshme dhe të tanishme të cilat organizata aplikuese dhe partnerët kanë zbatuar, në veçanti të ndërlidhura me themeljen publike	
Misioni i HandiKOS Gjakovë: Përfaqësimi dhe përkrahja e personave me aftësi të kufizuara duke avokuar dhe lobuar dhe duke ofruar shërbimet e rehabilitimit të bazuar në komunitet, për të arritur të drejta të barabarta, për një jetë të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë. Edhe pse zyrtarisht të themeluar më 01/07/2016, programet dhe eksperiencia e Handikos Gjakova datojnë që nga viti 1980 kur shërbente si shoqata e invalidëve e cila përfaqësonte të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar, më tej nga viti 1999 deri më 2016 kemi shërbyer si degë e organizatës Handikos Kosova, ndërsa nga Korriku 2016 jemi regjistruar si OJQ lokale me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore për PAK në nivel lokal. Organizata jonë është licensuar në Korrik 2019 dhe tani së fundmi është ri-licensuar dhe operon me një staf profesional, të licensuar nga MPMS edhe nga MSH ku në bazë të kësaj konsiston se ne jemi të obliguar të ofrojmë këto shërbime. Gjatë gjithë këtyre viteve që kemi ofruar shërbime për personat me aftësi të kufizuara, kemi arritur të krijojmë një besueshmëri tek komuniteti për cilësinë e shërbimeve tona. Me vetë faktin se kemi eksperiencë të gjatë në këtë fushë, nënkupton se shërbimet tona nuk kanë qenë të përkohshme dhe janë pjesë e planeve tona afatgjate. Handikos Gjakovë ka një përvojë të gjatë dhe solide në ofrimin e shërbimeve, duke ofruar shërbime të përgjithshme të rehabilitimit të bazuara në bashkësi (RBB) që nga viti 1999, në të cilat ka pilotuar dhe ofruar një sërë modelesh të shërbimeve sociale të bazuara në bashkësi, duke bërë vizita në shtëpi dhe referime duke ofruar pajisje ndihmëse, duke këshilluar të rriturit me aftësi të kufizuara vetë-kujdes dhe jetesë të pavarur dhe është e vetmja organizatë në komunë e cila ofron me profesionalizëm shërbime cilësore dhe mjete ndihmëse sipas nevojës për persona me aftësi të kufizuara. Fushëveprimtaria: 1. Mbrotjtje e personave me aftësi të kufizuara, 2. Ofrimi të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, 3. Pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike.	

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Bardhyl Qazimi, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

Handikos Gjakovë e ka fokusuar punën e saj në pesë lloje të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet: (1) rehabilitim primar fizikal dhe psiko-social, (2) shërbime të qëndrimit ditor, (3) shërbime të ofruara në shtëpi; (4) shërbime për jetesë të pavarur, dhe (5) shërbime për pajisje ndihmëse.

Këto shërbime deri më tani janë financuar nga donator të ndryshëm kryesisht ndërkombëtare (Handicap International, Fidida, Ambasada e Finlandës në Prishtinë, Unicef, Kynnys, Save the Children/Kosova, EU-KCSF, Fondacioni Margaret A. Cargill Philanthropy (MACP), Bashkimi Evropian në Kosovë, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar SIDA, Ambasada e Zvicres, Qeveria Lokale dhe Ministria e punës e mirqenies sociale).

26. A është kryer projekti/programi në në partneritet?

Jo

27. Përkruani rolin / kontributin e organizatave partnere në zbatimin e projektit / programit.

Nuk ka partnere

28. Si do të siguronit transferimin e njohurive dhe aftësive specifike ndërmjet organizatave partnere në projekt / program?

Nuk ka partneritet

29. Si planifikoni realizimin e aktiviteteve të projektit / programit për të përfshirë promovuesit / pranuesit / zbatuesit e politikave publike (në nivel lokal, apo nacional)?

Promovimin e përkrahjes së shërbimeve dhe programit të rehabilitimit të bazuar në komunitet, do ta promovojmë në nivel lokal dhe nacional si shembull apo praktik / model për financimin nga skemat shtetërore ku mbetet opcioni më i qëndrueshëm dhe të marrin hapa të planifikimit të buxhetit për këto shërbime. Organizim të shënimeve të datave me rëndësi për personat me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrje në krijimin e politikave dhe strategjive lokale me qëllim të përfshirjes së interesave të personave me aftësi të kufizuara e sidoms këtë vit si vitë i shpallur nga qeveria, "Viti 2022", viti i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara".

30. Përkruani se si keni ndërmend të përfshini qytetarët në projekt / program dhe për të informuar publikun e gjerë për të arriturat dhe rezultatet e projektit / programit.

Koha e gjatë e veprimit të Handikos Gjakovë-s si e vetmja organizatë në komunën e Gjakovës e cila ofron shërbime për PAK-t, ka bërë që gjatë gjithë kësaj periudhe të krijojmë marrëdhënie mjaft të mira me media lokale si Radio Gjakova dhe TV Syri Vision, andaj jemi të bindur që dhe gjatë realizimit të këtij projekti do të kemi bashkëpunim mjaft të ngushtë me këto medime duke na mundësuar organizimin e radio dhe TV debateve mbi promovimin e projektit e po ashtu në rrjetet sociale.

III. VLERËSIMI I REZULTATEVE

1. Përkruani rrugën që do të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të rezultateve të projektit / programit dhe ndikimin e tij në përmirësimin e objektivave të thirrjes publike.

Donatori i projektit MSH do të jetë i njoftuar në detaje për kohën e realizimit të projektit e po ashtu Menaxherja e projektit do të jetë pjesëmarrëse në menaxhimin e cilësisë së shërbimeve, menaxhimin e qendres dhe të gjitha aktiviteteve. Bordi i organizatës është i njoftuar me projektin dhe do të njoftohen për çdo aktivitet dhe inkurajohen që të monitorojnë çdo aktivitet që ata kanë dëshirë.

Numri i personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të cilët trajtohen në shërbimet e rregullta (fizioterapi, ergoterapi, mbështetje psikosociale, këshillim psikologjik, shërbime shëndetsore) (Database dhe raport nerativ)

Numri i tretmanëve të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha shërbimet.(Database dhe raport nerativ)

Numri i personave që kanë marrë pajisje ndihmëse të nevojshme si janë (karroca të llojeve të ndryshme, kukëza të llojeve të ndryshme, mjete për menaxhimin e inkontinencës, material higjienik sanitar, etj...)

Niveli i parandalimit dhe avancimit të gjendjes shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara (Plan i zhvillimor, arritja e objektivave, sipas manualit të punës të shërbimeve – Menaxhimi i Rastit)

Numri i iniciativave të marruara nga prindërit dhe familjarët, me qëllim të avancimit të pozitës së personave me aftësi të kufizuara.

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR SHËNDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE(DSHMS)

Postal address: Rr. "Rindhyt Qosha, 51000 Gjakovë, Republika e Kosovës

Numri i aktiviteteve rehabilituese kreativ-rekreative (raport nerativ)
